



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KËSHILLI I MINISTRAVE**

**PROJEKTVENDIM**

Nr. \_\_\_\_, Datë \_\_\_\_\_ 2016

**“PËR**

**PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT ‘PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË  
LIGJIN NR. 9920, DATË 19.5.2008 ‘PËR PROCEDURAT TATIMORE NË  
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË’, I NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 81, pika 1 dhe nenit 100 të Kushtetutës, me propozim të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave,

**V E N D O S I:**

Propozimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 ‘Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar”, për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, sipas tekstit dhe relacionit shoqërues që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE**

**VENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_, Datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2016

**“PËR  
DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR . 9920, DATË 19.5.2008 ‘PËR  
PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË’, I NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

**Neni 1**

Në nenin 6, pika 4, gërma a) dhe b) bëhen ndryshimet si më poshtë:

- Në fund të paragrafit a) të pikës 4 shtohet shprehja:

“në përputhje me dispozitat e Kodit Civil”

- Shkronja b) e pikës 4 ndryshon në përmbajtje si më poshtë:

“b) në rastin e një personi juridik të likuiduar, detyrimi tatimor pushon në datën e likuidimit dhe likuidatori ose përfaqësuesi, i caktuar ligjërisht në përputhje me Ligjin “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, është përgjegjës për llogaritjen dhe pagesën e tatimit të këtij personi.”

## Neni 2

Në nenin 10 “Udhëzimet teknike”, bëhet ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

- fjalia e dytë e pikës 2, ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

“Gjithashtu vendimi publikohet brenda 5 ditëve kalendarike ne faqen zyrtare te DPT-së, ne rubriken perkatese te Vendimeve Teknike, duke ruajtur të drejtën e konfidencialitetit të të dhënave të biznesit të tatimpaguesit. Vendimi bëhet detyrues për tatimpaguesin në datën që merr njoftim për të, në njërën nga format e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative dhe zbatohet njëjloj nga strukturat e administratës tatimore qendrore, për raste të tjera të ngjashme”

- Në nenin 10 , pas fjalisë së dytë shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dy herë në vit, në fund të cdo gjashtëmujori, përgatit komentare përmbledhës të vendimeve teknike në lidhje me mënyrën e trajtimit tatimor të rasteve specifike, duke i grupuar ato sipas natyrës së tyre. Këto komentare përmbledhës botohen në faqen zyrtare të DPT-se brenda muajit pasardhës të mbylljes së 6 mujorit”.

## Neni 3

Në nenin 16 “Struktura e administratës tatimore qendrore”, pikat 3, 4 dhe 5 shfuqizohen dhe zëvendësohen me pikat 3, 4 dhe 5 sipas përmbajtjes së mëposhtme:

“3.Administrata tatimore qendrore është e organizuar në departamente, drejtori, sektorë sipas funksioneve të mëposhtme:

a-Funksionet bazë ku bejnë pjese: regjistrimi, shërbimi, asistenca dhe edukimi i tatimpaguesve; menaxhimi i riskut, rimbursimi i tatimeve, kontrolli tatimor; mbledhja e detyrimeve tatimore/zbatimi i masave shtrënguese; hetimi tatimor; investigimi i brendshëm antikorrupsion

b- Funksionet mbështetëse ku bëjnë pjese: kontabiliteti, statistika dhe analiza, teknologjia e informacionit, shërbimi ligjor dhe teknik, shërbimet administrative dhe prokurimet, burimet njerezore dhe trajnimi, koordinimi dhe marrëdhëniet me të tretët.

4.Funksionet dhe detyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, drejtorive rajonale, të secilës drejtori, si dhe të njërive të tjera të administratës tatimore qendrore përcaktohen me rregullore të brendshme, e cila propozohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve dhe miratohet nga Ministri i Financave.

5.Ministri i Financave mund të vendosë që, në përputhje me legjislacionin në fuqi, të nënkontraktohen subjekte private, të specializuara, për realizimin e funksioneve të caktuara te parashikuara ne piken 3 , shkronja b të këtij neni.”

#### **Neni 4**

Neni 18 “Drejtoria e Apelimit tatimor”, shfuqizohet dhe zëvendësohet me këtë përmbajtje:

#### **“Neni 18 “Apelimi Tatimor”**

“1. Drejtoria e Apelimit Tatimor është funksion i pavarur në vendimmarrje, pjesë përbërëse e strukturës organike të Ministrisë së Financave.

2. Drejtori i Drejtorisë së Apelimit Tatimor emërohet nga Ministri i Financave. Punonjësit e Drejtorisë së Apelimit tatimor janë nënpunës civil dhe emërohen sipas dispozitave të Ligjit “Për nënpunësin Civil”.

3. Për qëllime të apelimit tatimor, në Ministrinë e Financave ngrihet “Bordi për shqyrtimin e apeliemeve tatimore”, në përberje të të cilit janë 9 anetare.

Për qëllime të kësaj pike, Këshilli i Ministrave miraton procedurat e shqyrtimit, vendimmarrjes, procedurat e funksionimit dhe përberjen e bordit të apelimit si dhe vlerën e detyrimeve vendimmarrja e të cilave bëhet nga ky bord.”

#### **Neni 5**

Neni 20 “Punësimi dhe kategoritë e punësimit”, ndryshon me këtë përmbajtje:

“1. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve merr masat për respektimin e dispozitave ligjore, për procedurat e punësimit dhe rekrutimit të personelit të administratës tatimore qendrore në përputhje me Kodin e Punes.

2. Nivelet e pagave për çdo kategori, miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Financave, pas bashkërendimit me DAP-in.”

#### **Neni 6**

Neni 22 “Procedura disiplinore”, ndryshon me këtë përmbajtje:

“1. Procedurat për shkeljet dhe masat disiplinore të nënpunësve të administratës tatimore qendrore që janë nënpunës civil behen në përputhje me ligjin për nënpunësin civil.

2. Për punonjësit e tjerë të administratës tatimore qendrore, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve shqyrton rastet e shkeljeve, të evidentuara dhe miraton masat disiplinore, në cilësinë e eprorit direkt.

3. Procedurat disiplinore fillojnë:

a) pas kërkesës, me shkrim, të eprorit, nëpunësit apo punonjësit të administratës tatimore;

- b) pas kërkesës me shkrim, të bërë nga tatimpaguesi;
- c) me nismën e Drejtorit të Përgjithshëm.

4. Për zbatimin e pikës 2 dhe 3 të këtij neni, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve miraton rregulloren e brendshme të institucionit, e cila detajon rastet e shkeljeve disiplinore në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

### **Neni 7**

Ne nenin 23 “Mënyrat e komunikimit me tatimpaguesin”, bëhet ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

- pika 2, lidheza “ose” që lidh paragrafin a) me paragrafin b) zëvendësohet me lidhëzën “dhe”.

- Pas pikës 3 shtohet pika 3.1 me përmbajtjen:

“Për qëllime të përcaktimit të fillimit të afatit për marrjen e akteve tatimore sipas këtij ligji, në llogaritjen e afateve, në përputhje me Kodin e Procedures Administrative, nuk përfshihet dita në të cilën del akti. Llogaritja e afatit fillon nga e nesërmja e ditës që akti është marrë ose konsiderohet të jetë marrë.”.

### **Neni 8**

Në nenin 28 “Informimi i publikut”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- “ - në fund të pikës 1 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, duke ruajtur të dhënat konfidenciale të tatimpaguesit, për qëllime të informimit, publikon në faqen e saj zyrtare të internetit, opinionet që japin qëndrime për zbatimin e legjislacionit tatimor. “

- në fund të pikës 2, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Administrata tatimore publikon dhe mban të përditësuar aktet ligjore dhe nënligjore tatimore edhe në gjuhën angleze.”

- pika 3 riformulohet me këtë përmbajtje:

“Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve publikon në faqen e saj të internetit çdo tre muaj nje buletin informativ mbi vendimet e formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit, të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese për çështjet tatimore dhe në bazë të të cilave reflekton vendimet teknike të cilat zbatohen për raste të tjera të ngjashme.””

### Neni 9

Në nenin 40 "Regjistrimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jotregtare " bëhet këto ndryshime:

" - Pika 2.2 riformulohet me këtë përmbajtje:

"2.2. Ministri i Financave nxjerr aktet nënligjore në zbatim të pikës 2.1 të këtij neni"

- Në pikën 4.1 gërma ç" ndryshon me këtë përmbajtje:

"ç) të vetëpunësuarit në veprimtari si shites ambulant, te cilët janë personat që ofrojnë mallra ose shërbime për publikun pa pasur një vend fiks tregtimi. Këta janë njësi të vetme tregtimi, të lëvizshme dhe lejohen të tregtojnë në ambiente publike pasi kanë marrë lejen nga Bashkia përkatëse."

### Neni 10

Në nenin 44 "Kalimi në regjistrin pasiv", pika 5 ndryshon në përmbajtje :

"5. Kur tatimpaguesi rifillon veprimtarinë, administrata tatimore automatikisht, transferon regjistrimin nga regjistri pasiv në regjistrin aktiv."

### Neni 11

Në nenin 45 "Çregjistrimi i subjekteve tatimore", pikat 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 ndryshojnë si më poshtë:

"3. Qendra Kombëtare e Biznesit ose gjykata njofton organin tatimor kompetent për regjistrimin e hapjes së procedurave të likuidimit ose për kërkesën për çregjistrim të personit fizik, apo për aplikimin për çregjistrim të personit juridik edhe kur kemi të bëjmë me aplikimin për çregjistrim pa kryerjen e likuidimit, në të njëjtën ditë me marrjen e kërkesës për çregjistrim.

4. Organi tatimor kompetent, brenda 10 ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së kërkesës për çregjistrim sipas pikës 3 të këtij neni, është i detyruar të verifikojë situatën tatimore të subjekteve dhe njofton njekohesisht QKB-në dhe subjektin. Kur organi tatimor sipas një analize risku, gjykon se është e nevojshme të ushtrojë kontroll në mjedisin ku ushtron veprimtarinë subjekti atëherë ky afat nuk mund të jetë më shumë se 30 dite, përfshirë kryerjen e kontrollit.

5. Qendra Kombëtare e Biznesit ose gjykata nuk mund të kryejë çregjistrimin, në qoftë se brenda afatit 30 ditor, të përmendur në pikën 4, të këtij neni, administrata tatimore e kundërshton me shkrim çregjistrimin. Kundërshtimi i çregjistrimit të tatimpaguesit nga administrata tatimore tregon shumë e detyrimeve tatimore të papaguara të tatimpaguesit dhe, në rastin e personit juridik, faktin se ai nuk ka paraqitur pasqyrat financiare të mbylljes së aktivitetit deri në momentin e likuidimit.

6. Nëse organi tatimor nuk i përgjigjet QKB-se ose gjykatës brenda afatit 30 ditor, QKB ose gjykata çregjistron automatikisht subjektin dhe njofton në të njëjtën ditë organin tatimor dhe subjektin.

Në rastin kur subjektet e regjistruara pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ose gjykatës

rezultojne me detyrime tatimore, ato çregjistrohen automatikisht pasi të kenë paguar të gjitha detyrimet tatimore, përfshirë detyrimet që lindin në rastin kur çregjistrimi kryhet me likuidim. Në momentin që subjekti paguan detyrimet tatimore, organi tatimor menjëherë njofton QKB-në, gjykatën dhe subjektin, që subjekti nuk ka detyrime tatimore të papaguara.

7. Në rastin kur kundërshtimi për çregjistrim nga organet tatimore është bërë si pasojë e mosdorëzimit të pasqyrave financiare atëherë me paraqitjen e këtyre pasqyrave financiare, organi tatimor kompetent detyrohet të tërheqë menjëherë kundërshtimin për çregjistrim dhe Qendra Kombëtare e Biznesit kryen menjëherë çregjistrimin e tatimpaguesit.

8. Nëse pavarësisht shlyerjes së detyrimit për të cilin është kundërshtuar çregjistrimi, organi tatimor kompetent nuk ka tërhequr kundërshtimin, atëherë subjekti paraqet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dokumentin që vërteton shlyerjen e këtyre detyrimeve tatimore. Në këtë rast Qendra Kombëtare e Biznesit kryen menjëherë çregjistrimin e subjektit dhe njofton menjëherë organin tatimor kompetent dhe subjektin.

9. Çregjistrimi tatimor nuk eliminon detyrimet ekzistuese tatimore dhe nuk parandalon administratën tatimore të vlerësojë ose të mbledhë detyrimet tatimore.

10. Për çdo procedurë që organi tatimor dhe QKB kryejnë sipas këtij neni, që kur fillon procedura e çregjistrimit dhe deri në çregjistrimin përfundimtar, i njoftohet në të njëjtën kohë edhe subjektit.”

#### **Neni 12**

Në nenin 50, pika 1 referenca për ligjin Nr 7928, datë 27.04.1995 “Për TVSH-ne” ndryshohet me referencën: 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar.

#### **Neni 13**

Në nenin 52 “Prodhimi dhe shpërndarja e dokumenteve tatimore”, shtohet pika 4 me përmbajtjen:

“4. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve me kërkesë të tatimpaguesit pavarësisht numrit të transaksioneve të kryera, lejon mospërdorimin e faturave tatimore sipas pikës 1 të këtij neni, kur tatimpaguesi është i aftë të lëshojë fatura tatimore kompjuterike me numër serial unik dhe të papërsëritshëm, të printuara nga sistemi i tij i regjistrimeve.

Ministri i Financave përcakton me udhëzim procedurën për zbatimin e kësaj pike.”

#### **Neni 14**

Në nenin 67 “Deklarata tatimore e ndryshuar”, pika 2 ndryshon në përmbajtje si vijon:

“Deklarata e ndryshuar mund të dorëzohet brenda 60 muajve nga afati i dorëzimit të deklaratës fillestare.”

#### **Neni 15**

Ne nenin 68 “Vlerësimi tatimor” pika 4, fjala “vëren” zëvendësohet me fjalën “konstaton”.

#### **Neni 16**

Ne nenin 69 “Njoftimi i vlerësimit tatimor dhe kërkesa për pagesën e detyrimit tatimor”, pika 2 shkronja d), ndryshon me kete përmbajtje:

“d) shumën e tatimit të vlerësuar, apo sipas rastit edhe uljen e humbjes tatimore, shumën e tatimit të refuzuar për rimbursim, kamatëvonesën, gjobat »

#### **Neni 17**

Ne nenin 76 “ behen këto shtesa:

- Në pikën 2 pas shprehjes “nenit 75” shtohet togfjalëshi “dhe nenit 75/1”.
- Në pikën 3 shtohet fjalia me përmbajtjen:  
“Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve publikon dhe perditeson ne faqen zyrtare te internetit, normën e interesit qe aplikon per llogaritjen e kamatëvonesës”

#### **Neni 18**

Në nenin 77 “Marrëveshja e pagesës me këste”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

- Pika 1 ndryshon në përmbajtje si më poshtë:

“1. Kur një rrethanë financiare pengon tatimpaguesin për të paguar në afat detyrimet tatimore, ai mund të lejohet të lidhë ne cdo kohe marrëveshje pagese me këste. Kjo marreveshje nuk mund te lidhet me shume se dy herë për të njëjtin detyrim tatimor dhe në të njejten kohe tatimpaguesi duhet te vertetoje qe eshte ne kushtet e pamundesise financiare per te paguar detyrimin tatimor.”

- Pika 6 ndryshon në përmbajtje si më poshtë:

“6. Në rastin kur tatimpaguesi hyn në një marrëveshje të pagesës me këste me administratën tatimore, duke filluar nga muaji që pason muajin në të cilin marrëveshja është vendosur deri në përfundimin e afatit të marrëveshjes me kushtin që marreveshja të jetë përmbushur tërësisht, nuk llogaritet kamatëvonesë sipas nenit 76 të këtij ligji.”

- Pas pikës 6 shtohet pika 7 dhe 8 me përmbajtjen si më poshtë:

“7. Marreveshja për pagesë me këste mund të lidhet për detyrime tatimore të vendosura nga administrata tatimore për një vlerësim tatimor të kryer sipas nenit 69 të ligjit si dhe për detyrime tatimore të vetdeklaruar nga tatimpaguesi.

8. Në rastin kur rezulton se për tatimpaguesin ka filluar mbledhja me force e detyrimeve



tatimore ne përputhje me nenin 91 te këtij ligji, pavarësisht lidhjes se marrëveshjes se pagesës me këste, administrata tatimore, per te siguruar pagesën e detyrimit tatimor nuk heq dore nga kjo mase.”

## Neni 19

Ne nenin 81 “Njoftimi i kontrollit tatimor”, bëhen këto shtesa:

- Në pikën 1, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“1. Njoftimi i kontrollit tatimor i dergohet tatimpaguesit te pakten 45 ditë përpara datës së fillimit të kontrollit tatimor të shkruar në njoftim, përveç kur kontrolli kryhet si rezultat i kërkesës së tatimpaguesit për rimbursim.

Në rastin e kryerjes së vizitave fiskale, të cilat janë kontrole të shkurtra të kryera gjate një periudhe te shkurtër kohore për te verifikuar saktësinë e deklaratave dhe pagesave, si rregull vetëm për një periudhe te caktuar tatimore dhe vetëm për një lloj tatimi, njoftimi i vizites fiskale i dergohet tatimpaguesit te pakten 15 dite perpara dates se fillimit te vizites fiskale.”

- Në pikën 2, shtohet gërma f) ndryshon me këtë përmbajtje:

f) datën dhe orën kur fillon dhe kur përfundon kontrolli tatimor. Kohëzgjatja e nevojshme e kontrollit përcaktohet nga të dhënat e analizës së riskut.

- Në fund të pikës 2 shtohet paragrafi me përmbajtjen:

“ Afati për kryerjen e kontrollit i përcaktuar ne perputhje me gërmën f) mund te zgjatet pas miratimit nga Drejtori i Pergjithshem i Tatimeve, por jo më shumë se 15 ditë pune.”

- Shtohet pika 3 dhe 4 me përmbajtjen e mëposhtme:

3.Me njoftimin e kontrollit tatimor, tatimpaguesit i jepet mundesia te deklaroje çdo te dhene per transaksione te padeklaruara, per te cilat nuk eshte paguar tatim. Ky deklarim kryhet nepermjet nje formulari-pyetesor qe i vihet ne dispozicion se bashku me njoftimin per kontroll, brenda 45 ditëve në Drejtorinë Rajonale Tatimore, perpara fillimit te kontrollit tatimor.

4. Tatimpaguesi deklaron dhe paguan menjehere detyrimin tatimor me deklaraten tatimore qe i perket periudhes korente kur behet deklarimi. Kamatevonesat per detyrimin perkates fillojne te llogariten ne perputhje me nenin 76 te ketij ligji qe nga data e deklarimit te kryer sipas ketij neni.

5. Per deklarimin e kryer perpara fillimit te kontrollit tatimor sipas pikes 3 te ketij neni, aplikohet dënim administrativ në masën 30% të detyrimit tatimor.

6. Në të kundert nëse tatimpaguesi nuk deklaron sipas pikes 3 te ketij neni, përpara fillimit të kontrollit, prezumohet që nuk ka për të deklaruar dhe për cdo detyrim tatimor apo shkelje te konstatuar gjate kontrollit aplikohen kamatevonesat dhe denimet adminsitrative sipas ketij ligji.

## **Neni 20**

Ne nenin 83 “Raporti i Kontrollit Tatimor”, pika 3 ndryshon me këtë përmbajtje:

“ 3.Raporti i kontrollit miratohet nga struktura perkatëse e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, përfshirë përgjegjësin e sektorit dhe drejtorin e kontrollit. Një kopje e raportit të kontrollit i jepet drejtorit të drejtorisë rajonale të tatimeve dhe një kopje i dërgohet me postë tatimpaguesit.

Për detyrime tatimore (tatim, gjobë, kamatëvonesë) që rezultojnë nga raporte kontrolli, në shumën mbi 10 milion leke, Drejtori Rajonal krijon grup pune me 5 përfaqesues të Drejtorisë Rajonale, të cilët miratojnë rezultatet e Raportit të kontrollit.”

## **Neni 21**

Ne nenin 85 “Rikontrolli” shtohet pika 4 me përmbajtjen:

“4. Vendimi i miratimit të rikontrollit nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, vendim në të cilin janë shprehur aresyet e rikontrollit, i vihen në dispozicion tatimpaguesit së bashku me Njoftimin e Kontrollit tatimor.”

## **Neni 22**

Neni 104, shfuqizohet

## **Neni 23**

Në nenin 105 “ Struktura dhe funksionet e njërive të Hetimit Tatimor” pas pikës 5 shtohet pika 6 me përmbajtjen:

“6. Drejtori i Drejtorisë së Hetimit Tatimor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorët e Hetimit Tatimor në Drejtoritë Rajonale tatimore emërohen nga Ministri i Financave.”

## **Neni 24**

Ne nenin 105/2 “Struktura dhe funksionet e avokatit të tatimpaguesit”, pikat 5,6 dhe 8 ndryshojnë me përmbajtjen e më poshtme:

“5. Avokati i tatimpaguesit është strukturë e pavarur në përbërje të Ministrisë së Financave dhe emërohet nga Ministri i Financave.

6. Autoriteti, funksionet e bashkëpunimi i Avokatit të Tatimpaguesve me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe me palët e treta përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

8. Manuali i Avokatit të Tatimpaguesve, i cili duhet të përmbajë procedura të hollësishme dhe proceset e punës për mbledhjen e informacionit, evidentimin dhe përpunimin e ankesave të tatimpaguesve, zgjedhjen dhe trajtimin e ankesave e të shqetësimeve të tatimpaguesve, përgjithësimin e rasteve, mbylljen e rasteve, si dhe treguesit e matjes së performancës së punës dhe procedurat e raportimit, miratohet nga Ministri i Financave.”

### **Neni 25**

Ne nenin 106 “Objekti i ankimit administrative tatimor” bëhen këto shtesa:

- në fund të pikes 1, shtohet përmbajtja:

“në përputhje me Kodin e Procedures administrative, përvec se kur ne kete ligj percaktohet ndryshe.”

- pas pikës 1, shtohet pika 1.1 me përmbajtjen e mëposhtme:

“1.1 Përfundimisht nga pika 1 e këtij neni, nuk janë objekt i apelimit tatimor dhe ne perputhje me kodin e procedures administrative, autoriteti tatimor perkates eshte pergjegjese per anulimin e akteve administrative me qellim sistemimin e situatave te tatimpaguesit per denime tatimore te gjeneruara automatikisht nga sistemi i informatik, te njoftuara nga Administrata Tatimore, te cilat nuk perfaqsojnw shkelje te legjislacionit tatimor nga tatimpaguesi por jane rrjedhoje e veprimeve te administrates tatimore.

### **Neni 26**

Ne nenin 108 “Kompetenca per shqyrtimin e ankimit tatimor” behen ndryshimet si me poshte:

- Kudo ne permbajtje te nenit 108 pas shprehjes “Drejtoria e Apelimit Tatimor” shtohet shprehja “ose Bordi per shqyrtimin e apelimeve tatimore”.

- Pika 5 ndryshon ne permbajtje si me poshte:

“5. Barra e provës, për të vërtetuar se një vlerësim tatimor ose vendim është i pasaktë, ushtrohet ne perputhje me Kodin e procedures administrative”

- Ne piken 6 fjalet “ ne perputhje me nenin 108 te kodit te Procedures administrative” ndryshojne “ne perputhje me nenin 100 te kodit te Procedures administrative”

- Pas pikes 6 shtohet pika 7 me permbajtjen:

“Bordi per shqyrtimin e apelimeve tatimore ka per kompetence te shqyrtoje dhe te marre vendim per ankimin tatimor qe ka per objekt detyrimin tatimor sipas vleres se percaktuar me Vendim te Keshillit te Ministrave”

### **Neni 27**

Ne nenin 109 “Vendimi i Drejtorise se Apelimit Tatimor” bëhen këto ndryshime:

- Kudo ne permbajtje te nenit 109 pas shprehjes “Drejtoria e Apelimit Tatimor” shtohet shprehja “ose Bordi për shqyrtimin e apelimeve tatimore”.
- pika 3 e nenit ndryshon në përmbajtje si vijon:

“3. Vendimi i drejtorisë së apelimit tatimor ose i Bordit për shqyrtimin e apelimeve tatimore është i detyrueshem për zbatim nga organi i administrates tatimore që ka bërë vlerësimin tatimor.

#### **Neni 28**

Ne nenin 110 “Rimbursimi i detyrimit tatimor, pagesa e kamatëvonesës dhe e gjobës”, behen ndryshimet si me poshte:

- Kudo ne permbajtje te nenit 110 pas shprehjes “Drejtoria/se e/se Apelimit Tatimor” shtohet shprehja “ose Bordi/t për shqyrtimin e apelimeve tatimore”.
- Ne piken 1 hiqet shprehja “dhe administrata tatimore e pranon vendimin”
- Pika 3 shfuqizohet.

#### **Neni 29**

Neni 113 “Mosdeklarimi ne afat” ndryshohet si me poshtë:

“Tatimpaguesi, i cili nuk dorëzon deklaratën tatimore në afat, dënohet me gjobë për çdo deklaratë tatimore të padorëzuar si më poshtë:

- 10 000 lekë per tatimpaguesit e tatimit mbi fitimin;
- 5 000 leke per tatimpaguesit e tjerë”

#### **Neni 30**

Ne nenin 114, pika 2 shfuqizohet fjalia e dytë me përmbajtjen “Shumë e papaguar e detyrimit tatimor konsiderohet edhe ulja e tepricës kreditore të tatimpaguesit, në rastin e një rivlerësimi tatimor.”

#### **Neni 31**

Ne nenin 114/1 “Mospagimi në afat i kësteve paraprake të tatimit mbi fitimin ose kësteve paraprake të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin” togfjalëshi “ sipas nenit 30, të ligjit nr. 8438, datë

28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, zëvendësohet me togfjalëshin me këte përmbajtje: " përkatësisht sipas nenit 30, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, dhe nenit 15 të Ligjit Nr 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave vendore", i ndryshuar.

### **Neni 32**

Ne nenin 115, pika 2 shfuqizohet fjalia e dyte me këte përmbajtje: " Shumë e papaguar e detyrimit tatimor konsiderohet edhe deklarimi i pasaktë i tepricës kreditore, e cila llogaritet si diferencë e tepricës kreditore që duhet deklaruar me tepricën kreditore të deklaruar."

### **Neni 33**

Neni 117 " Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave" ndryshon në përmbajtje si mëposhtë:

"Agjenti i mbajtjes së tatimit në burim, agjenti i taksave apo tarifave, detyrohet të paguajë gjobë në masën e mëposhtme:

- a. gjobë në masën 0.06 % të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës, në rast se e ka mbajtur, llogaritur dhe raportur tatimin në burim apo tatimet, taksat dhe tarifatat, por nuk e ka transferuar atë në buxhetin e shtetit.
- b. gjobë në masën 50 % të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës në rast se nuk mban tatimin në burim apo tatimet, taksat dhe tarifatat e mbledhura;
- c. gjobë në masën 100 % të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës nëse mban dhe nuk raporton tatimin në burim apo tatimet, taksat dhe tarifatat e mbledhura.

### **Neni 34**

Neni 119 "Mosdeklarimi i punonjësve" ndryshon në titull dhe përmbajtje si më poshtë:

"Neni 119 "Mosdeklarimi i punonjësve dhe fshehja e pages"

1. Nëse nga verifikimi dhe kontrolli në vendndodhjen e biznesit rezulton se tatimpaguesi nuk ka deklaruar në organin tatimor çdo të punësuar rishtazi, të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës, përveç detyrimit për pagimin e shumës së detyrimeve tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të llogaritura nga data e konstatimit, dënohet me gjobë për çdo punonjës të padeklaruar:
  - a) tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimit mbi fitimin, me gjobë prej 200 000 (dyqind mijë) lekë;
  - b) tatimpaguesit e tjerë, me gjobë prej 50 000 (pesedhjetë mijë) lekë.

Kjo gjobë nuk aplikohet në rastin kur nga verifikimi dhe kontrolli në vendndodhjen e aktivitetit të personit fizik të vetëpunësuar, evidentohen persona mbi 16 vjeç të cilët

kategorizohen si persona të papaguar të familjes. Ne kete rast pas konstatimit, tatimpaguesit përkatës i lihet kohë deri në 5 ditë kalendarike që të vërtetojë pranë organit tatimor se personi i evidentuar në vendin e aktivitetit është person i papaguar i familjes ose që bashkëjeton ligjërisht me të vetëpunësuarin sipas kuptimit në Kodin Civil.

2. Nëse nga verifikimi dhe kontrolli rezulton se tatimpaguesi ka fshehur dhe nuk ka deklaruar pagën e saktë të përfituar nga punëmarresi si rezultat i marrëdhënies së punësimit, tatimpaguesi-punëdhënës përveç detyrimit për pagimin e shumës së detyrimit tatimor dhe kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të llogaritur për gjithë periudhën që provohet se është kryer shkelja, dënohet me gjobë në masën 100% të detyrimit dhe kontributit të llogaritur. “

### Neni 35

Ne nenin 121 “Mallrat e pashoqëruara me dokumente tatimore”, ndryshon në përmbajtje si më poshtë:

“ Për tatimpaguesin që mban në ruajtje, përdor ose transporton mallra të pashoqëruara me dokumente tatimore, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, aplikohen masat dhe denimet si më poshtë:

- Tatimpaguesi i Tatimit të Thjeshtuar të Fitimit të cilët nuk janë të regjistruar për TVSH-ne, menjëherë në momentin e konstatimit i ndryshohet përgjegjësia tatimore duke kaluar si tatimpagues i TVSH-se. Për qëllim të konstatimit të mosdokumentimit të mallit detyrohet të lëshojë faturë sipas nenit 53 të këtij ligji dhe dënohet me gjobë në masën 50 000 lek.
- Tatimpaguesi i regjistruar për TVSH-ne, detyrohet të dokumentojë mallin duke lëshuar fature tatimore sipas nenit 53 të këtij ligji. Për qëllim të konstatimit të mosdokumentimit të mallit i kryhet rivlerësim i shitjeve në të njëjtën vlerë me vlerën e tregut të mallit të padokumentuar dhe aplikohet dënim sipas nenit 124, pika 1, të këtij ligji.

### Neni 36

Ne nenin 122 “Kundërvajtjet administrative në përdorimin e pajisjeve fiskale, për lëshimin e kuponave fiskalë e të biletave” bëhen ndryshimet si më poshtë:

- Fjalja e parë e pikës 1, ndryshohet me këtë përmbajtje:

“1. Tatimpaguesi, person juridik ose fizik, tregtar, i cili detyrohet të perdore pajisjen fiskale ose sistemet e monitorimit të qarkullimit në përputhje me përcaktimet e këtij ligji, dënohet në rast se:

- Pika 1 shkronja a) paragrafit ii) ndryshon në përmbajtje si më poshtë:

“ ii) nëse pas verifikimit të parë, sipas nënndarjes “i”, të këtij neni, konstatohet se

tatimpaguesi vazhdon të mos e instalojë pajisjen fiskale për regjistrimin e pagesave me para në dorë, ose sistemin e monitorimit të qarkullimit, merret masa e bllokimit të veprimtarisë në vendin ku është konstatuar shkelja për 15 dite kalendarike dhe i publikohet emri i tatimpaguesit, Nipti dhe emri i perfaqesuesit të biznesit në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.”

- Pika 1, shkronja b) ndryshon si më poshtë :

“b) nuk lëshon kupon tatimor për të dokumentuar qarkullimin e realizuar të mallrave apo të shërbimeve:

i) për çdo konstatim (verifikim) të kryer, me gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë dhe përveç mases së gobes për tatimpaguesit e regjistruar për TVSH-në bëhet vlerësim tatimor për tre muajt e fundit, duke përdorur metodat alternative të parashikuara në nenet 71 dhe 72 të këtij ligji.

ii) për çdo konstatim (verifikim) tjetër pas konstatimit të parë, sipas shkronjës “i”, të kesaj pike, nëse tatimpaguesi vazhdon të mos e lëshojë kuponin tatimor për të dokumentuar qarkullimin e realizuar të mallrave apo të shërbimeve, përveç aplikimit të dënimit si në pikën i), merret masa e bllokimit të veprimtarisë në vendin ku është konstatuar shkelja për 30 dite kalendarike dhe i publikohet emri i tatimpaguesit, Nipti dhe emri i perfaqesuesit të biznesit në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

iii) për çdo konstatim të përsëritur të moslëshimit të kuponit tatimor, përveç aplikimit të dënimit si në pikën i), konsiderohet evazion tatimor sipas nenit 116 të ligjit dhe administrata tatimore ushtron të drejtën e parashikuar në nenin 131 të këtij ligji duke e kallëzuar penalisht tatimpaguesin”

- shkronja c) ndryshon në përmbajtje si më poshtë:

“c) lëshon një kupon tatimor/dëftesë tatimore/biletë me vlerë të parashtypur, që nuk përmban elementet e përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore, për kuponin tatimor/dëftesën tatimore/biletën me vlerë të parashtypur, me gjobë, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.”

ç) lëshon kupon tatimor/deftesë tatimore, ku ka shënuar një vlerë të ndryshme nga vlera e furnizimit ose e çmimit të afishuar, me gjobë në masën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë;

- shkronja d) ndryshohet si më poshtë:

“d) nuk afishon në një vend të dukshëm një poster, që tregon detyrimin e blerësit të mallrave apo të përfituesit të shërbimit për të kërkuar kupon tatimor, ose një poster që tregon të drejtën e blerësit për të mos paguar për mallrat dhe shërbimet e blera, në zbatim të pikës 3, të nenit 46, të këtij ligji, me gjobë në masën 50 000 (dhjetë mijë) lekë, për secilën nga shkeljet në këtë paragraf.”

- shkronja e) shfuqizohet

### Neni 37

Ne nenin 124 pika 2 shfuqizohet dhe zevendesohet me piken 2, 3 dhe 4 si më poshtë si dhe ndryshon numerimi per piken 3 dhe 4, ne 5 dhe 6:

- “ 2. Moslëshimi i faturës tatimore, dëftesës tatimore apo i faturës tatimore me TVSH, dënohet me gjobë të barabartë me 100 për qind të tatimit të padeklaruar, si rezultat i moslëshimit të faturës, përveç tatimit dhe kamatvonesave që llogariten dhe paguhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji apo të ligjeve specifike tatimore.
3. Per tatimpaguesit qe kryejne shkelje te perseritur te moslëshimit te fatures, pervecse aplikohet denimi me gjobë të barabartë me 100 për qind të tatimit të padeklaruar, sipas pikes 1 te ketij neni, gjithashtu ndermerren masat si me poshte :
  - tatimpaguesit që nuk eshte i regjistruar për TVSH-në, i ndryshohet pergjegjesia tatimore dhe regjistrohet me kete pergjegjesi sapo konstatohet shkelja e perseritur;
  - tatimpaguesit te regjistruar per TVSH dhe tatimin e thjeshtuar te fitimit, i ndryshohet pergjegjesia dhe regjistrohen per Tatimin mbi Fitimin.
  - tatimpaguesi i Tatimit mbi Fitimin, perfshihet menjehere ne listen e subjekteve me risk per efekt te analizes se riskut.
4. Në rastet kur moslëshimi i faturës tatimore, dëftesës tatimore apo i faturës tatimore me TVSH, eshte shkelje e perseritur nga tatimpaguesi me shume se 2 here, atehere pervec sa percaktohet ne piken 1 dhe 2 te ketij neni, zbatohen edhe dispozitat e neneve 116 dhe 131 të këtij ligji”

### Neni 38

Në nenin 128/3 “Denimet per certifikimin e pasqyrave financiare nga audituesit”, ndryshon ne permbajtje si me poshte:

“Në rast se nga kontrolli i bërë nga administrata tatimore tek tatimpaguesit, pasqyrat financiare të të cilëve janë certifikuar nga kompanitë audituese se janë në përputhje me legjislacionin fiskal, rezulton detyrim tatimor, masa e detyrimit tatimor i ngarkohet e plotë tatimpaguesit, ndërsa kompania certifikuese dënohet me një gjobë në masën 50% të detyrimit tatimor që i ngarkohet tatimpaguesit.”



### **Neni 39**

Neni 130 “Mosafishimi i çmimeve të shitjes” ndryshon si me poshte:

“Mosafishimi i çmimeve të shitjes së mallrave apo shërbimeve dënohet me gjobë me 100 000 lekë për tatimpaguesit e Tatimit mbi fitimin dhe 50.000 lekë për tatimpaguesit e tjere.

Ministri i Financave percakton me udhezim rastet kur per natyren e aktivitetit permbushja e ketij detyrimi per afishimin e cmimeve te sherbimeve nuk mund te ushtrohet.

### **Neni 40**

Kudo në përmbajtje të këtij ligji fjala “QKR” apo “Qendra Kombetare e Regjistrimit” ndryshohet me termin “QKB” ose “Qendra Kombëtare e Biznesit”.

### **Neni 41**

Ky ligj hyn në fuqi me 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

**ILIR META**

**KRYETAR I KUVENDIT**